



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 4**

**29 janar**

**2013**

## P Ë R M B A J T J A

|                                          | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Urdhër i MD<br>nr. 23/11, datë 24.1.2013 | Për rishpërndarjen sipas njësive vendore të numrit të përgjithshëm të noterëve të caktuar në vitin 2011 dhe shpalljen e vendeve vakante..... 83                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Urdhër i MF<br>nr. 1, datë 14.1.2013     | Për shpalljen e disa ndryshimeve të ndodhura gjatë vitit 2012, në disa Standarde Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)..... 87                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Vendim i ERE<br>nr. 1, datë 10.1.2013    | Për miratimin e rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” ..... 109                                                                                                                                                                                                                           |
| Vendim i ERE<br>nr. 3, datë 11.1.2013    | Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të administratorit, në zbatim të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 158, datë 16 nëntor 2012 “Për fillimin e procedurës për heqjen e licencave për aktivitetin e shpërndarjes dhe aktivitetit të furnizimit publik me pakicë” ..... 109                                                                                                                                |
| Vendim i ERE<br>nr. 4, datë 21.1.2013    | Për heqjen e licencave të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. “Për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 8, datë 25.1.2008, të ndryshuar dhe për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimet e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 25.1.2008, të ndryshuar..... 110                                                                                       |
| Vendim i ERE<br>nr. 5, datë 21.1.2013    | Për vendosjen e shoqërisë “CEZ shpërndarje” sh.a., në administrim të përkohshëm dhe emërimin e administratorit të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., në zbatim të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013 “Për heqjen e licencave për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe aktivitetit të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.” ..... 111 |

**URDHËR**  
**Nr. 23/11, datë 24.1.2013**

**PËR RISHPËRNDARJEN, SIPAS NJËSIVE VENDORE, TË NUMRIT TË PËRGJITHSHËM  
TË NOTERËVE TË CAKTUAR NË VITIN 2011 DHE SHPALLJEN E VENDEVE  
VAKANTE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 16 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar, bazuar në studimin e kryer në janar 2013,

**KONSTATOJ SE:**

Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr. 2140, datë 18.3.2011 “Për caktimin e numrit të përgjithshëm të noterëve dhe numrit të tyre sipas njësive vendore”, numri i përgjithshëm i noterëve është 378. Në vijim të urdhrit nr. 213, datë 18.5.2012 të Ministrit të Drejtësisë, në datë 2-3.6.2012, u zhvillua konkursi për vendet e shpallura vakante. Nga ky konkurrim rezultuan fitues 25 kandidatë, të cilët plotësuan 23 vende vakante. Dy nga kandidatët e shpallur fitues, në përputhje me ligjin nr. 7829/1994, plotësuan vendin vakant të lënë nga prindi i tyre. Më pas me urdhrin nr. 275, datë 13.6.2012 të Ministrit të Drejtësisë, u rishpallën vakante 63 vendet e mbetura, sipas së njëjtës shpërndarje në njësitë e qeverisjes vendore të përcaktuara më parë. Nga konkursi i zhvilluar më datë 30.6.2012 rezultuan fitues 13 kandidatë, të cilët plotësuan 13 vende vakante.

Bazuar në një studim të kryer në shtator 2012, me urdhrin nr. 195/2, datë 3.10.2012 të Ministrit të Drejtësisë “Për rishpërndarjen sipas njësive vendore të numrit të përgjithshëm të noterëve të caktuar në vitin 2011 dhe shpalljen e vendeve vakante”, u ripërcaktua numri i noterëve për çdo njësi vendore, si dhe u shpallën vendet vakante të mbetura të paplotësuara nga procedurat e mëparshme të konkurrimit. Mbi bazën e këtij urdhri, u zhvilluan dy procedura konkurrimi, më datë 8.12.2012 dhe 12.1.2013, nga ku mbetën përsëri 19 vende vakante.

Pas zhvillimit të katër procedurave konkurruese, rezulton se në Republikën e Shqipërisë ushtrojnë aktualisht veprimtarinë 359 noterë. Në këtë kuadër, mbeten 19 vende vakante.

Neni 16 i ligjit nr. 7829/1994, përcakton që vendimmarrja për shpërndarjen e numrit të noterëve të mbajë në konsideratë dy kriteret themelore:

- a) numrin e popullsisë së bashkisë së bashku me komunat rreth saj;
- b) vëllimin e punës së veprimtarisë noteriale.

Në këtë kuadër, duke vlerësuar edhe mungesën e kërkesave gjatë katër procedurave të para të konkurrimit, për shumë nga vendet vakante të shpallura për njësitë e ndryshme vendore, vlerësohet si domosdoshmëri, rishpërndarja e vendeve vakante, pikërisht bazuar në dy kriteret ligjore të specifikuar në ligjin nr. 7829/1994. Rishpërndarja duhet të udhëhiqet nga kriteret e vendosura nga ligji, si dhe nga parimet e efencës dhe shpejtësisë së shërbimit, mbulimit me shërbim noterial të të gjitha njësive administrative vendore, ngarkesës së noterëve, si dhe numrit të veprimeve noteriale për çdo banor.

Përmbushja njëherazi i të gjitha kriterëve dhe parimeve që duhet të udhëheqin këtë proces, kërkon analizimin me kujdes të numrit të noterëve për çdo njësi vendore, numrit të popullsisë, numrit të veprimeve noteriale, si dhe vendeve vakante të shpallura për këtë njësi vendore, në funksion të përcaktimit të:

- a) nevojës për shtesë të numrit të noterëve në disa njësi vendore;
- b) nevojës për vende vakante, në njësitë e përcaktuara nga urdhri nr. 195/2/2012, i Ministrit të Drejtësisë;



c) cilësisë dhe shpejtësisë në ofrimin e shërbimeve noteriale në njësitë vendore.

Referuar studimit të muajit janar 2013, rishpërndarja e numrit të përgjithshëm të noterëve është bërë sipas standardeve ndërkombëtare, duke u bazuar në dy kritere:

1. Numri i popullsisë në njësitë vendore të caktuara;
2. Numri i transaksioneve.

Në këtë studim është sugjeruar që pa ndryshuar numrin e përgjithshëm të noterëve, pozicionet e vendeve vakante duhen rishpërndarë, duke u bazuar kryesisht te vëllimi i veprimtarisë noteriale dhe ngarkesa në punë e noterëve, si dhe numri i kërkesave për konkurrim. Për këtë qëllim, del e nevojshme që, bazuar në studimin e kryer nga Ministria e Drejtësisë në janar 2013, të bëhet përcaktimi i numrit të noterëve sipas njësive vendore dhe vendet vakante të rishpërndahen bazuar në kriteret e parashikuara nga ligji dhe standardet ndërkombëtare.

#### PËR KËTË ARSYE,

Ministri i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

#### URDHËRON:

1. Rishpërndarja sipas njësive vendore të numrit të përgjithshëm të noterëve, të jetë sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Shpalljen e vendeve vakante për njësitë vendore, sipas aneksit 2 bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Urdhri nr. 195/2, datë 3.10.2012 i Ministrit të Drejtësisë “Për rishpërndarjen sipas njësive vendore të numrit të përgjithshëm të noterëve të caktuar në vitin 2011 dhe shpalljen e vendeve vakante”, revokohet.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij urdhri dhe dërgimin e tij për botim në Fletoren Zyrtare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË  
**Eduard Halimi**

ANEKSI 1

| Nr. | Bashki/Komuna       | SHPËRNDARJA<br>E<br>NOTERËVE |
|-----|---------------------|------------------------------|
| 1.  | Bashkia B. Curri    | 2                            |
| 2.  | Bashkia Ballsh      | 2                            |
| 3.  | Bashkia Berat       | 7                            |
| 4.  | Bashkia Bilisht     | 2                            |
| 5.  | Bashkia Bulqizë     | 2                            |
| 6.  | Bashkia Burrel      | 2                            |
| 7.  | Bashkia Cërrik      | 1                            |
| 8.  | Bashkia Çorovodë    | 1                            |
| 9.  | Bashkia Delvinë     | 1                            |
| 10. | Bashkia Divjakë     | 1                            |
| 11. | Bashkia Durrës      | 39                           |
| 12. | Bashkia Elbasan     | 18                           |
| 13. | Bashkia Ersekë      | 1                            |
| 14. | Bashkia Fier        | 17                           |
| 15. | Bashkia Fushë Krujë | 2                            |
| 16. | Bashkia Gramsh      | 3                            |
| 17. | Bashkia Gjirokastër | 5                            |
| 18. | Bashkia Himarë      | 1                            |
| 19. | Bashkia Kamëz       | 2                            |
| 20. | Bashkia Kavajë      | 10                           |
| 21. | Bashkia Koplik      | 1                            |
| 22. | Bashkia Korçë       | 9                            |
| 23. | Bashkia Krujë       | 2                            |
| 24. | Bashkia Krumë       | 1                            |
| 25. | Bashkia Kuçovë      | 2                            |
| 26. | Bashkia Kukës       | 4                            |
| 27. | Bashkia Laç         | 3                            |
| 28. | Bashkia Lezhë       | 6                            |
| 29. | Bashkia Librazhd    | 3                            |
| 30. | Bashkia Lushnjë     | 9                            |
| 31. | Bashkia Maliq       | 1                            |
| 32. | Bashkia Mamurras    | 1                            |
| 33. | Bashkia Orikum      | 1                            |
| 34. | Bashkia Peqin       | 2                            |
| 35. | Bashkia Peshkopi    | 3                            |



|              |                       |            |
|--------------|-----------------------|------------|
| 36.          | Bashkia Përmet        | 2          |
| 37.          | Bashkia Pogradec      | 6          |
| 38.          | Bashkia Pukë          | 2          |
| 39.          | Bashkia Rrëshen       | 2          |
| 40.          | Bashkia Rrogozhinë    | 1          |
| 41.          | Bashkia Sarandë       | 8          |
| 42.          | Bashkia Sukth         | 2          |
| 43.          | Bashkia Shijak        | 5          |
| 44.          | Bashkia Shkodër       | 19         |
| 45.          | Bashkia Tepelenë      | 2          |
| 46.          | Bashkia Tiranë        | 132        |
| 47.          | Bashkia Vau Dejës     | 1          |
| 48.          | Bashkia Vlorë         | 21         |
| 49.          | Bashkia Vorë          | 2          |
| 50.          | Komuna Farkë          | 1          |
| 51.          | Komuna Kashar         | 1          |
| 52.          | Komuna Paskuqan       | 2          |
| 53.          | Komuna Qendër - VLORE | 1          |
| 54.          | Komuna Rashbull       | 1          |
| <b>TOTAL</b> |                       | <b>378</b> |

*ANEKSI 2*

| <b>Nr.</b>   | <b>Bashki/Komuna</b> | <b>Vendet vakante</b> |
|--------------|----------------------|-----------------------|
| 1.           | Bashkia Cërrik       | 1                     |
| 2.           | Bashkia Delvinë      | 1                     |
| 3.           | Bashkia Durrës       | 5                     |
| 4.           | Bashkia Elbasan      | 1                     |
| 5.           | Bashkia Fier         | 2                     |
| 6.           | Bashkia Lushnjë      | 1                     |
| 7.           | Bashkia Maliq        | 1                     |
| 8.           | Bashkia Pogradec     | 1                     |
| 9.           | Bashkia Rrogozhinë   | 1                     |
| 10.          | Bashkia Sukth        | 1                     |
| 11.          | Bashkia Shijak       | 1                     |
| 12.          | Bashkia Shkodër      | 1                     |
| 13.          | Bashkia Vlorë        | 2                     |
| <b>TOTAL</b> |                      | <b>19</b>             |

**URDHËR**  
**Nr. 1, datë 14.1.2013**

**PËR SHPALLJEN E DISA NDRYSHIMEVE TË NDODHURA GJATË VITIT 2012, NË DISA  
STANDARDE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF)**

Në mbështetje të nenit 4 pika 3 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 672, datë 26.10.2005 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit” dhe sipas vendimit nr. 3, datë 24.10.2012 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit,

**URDHËROJ:**

1. Shpalljen për zbatim të disa ndryshimeve të ndodhura gjatë vitit 2012 në disa Standarde Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, dhe të përkthyer në shqip nga gjuha angleze nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, si më poshtë:

- ndryshime në Standardet e Raportimit Financiar (SNRF) nr. 10, nr. 11, nr. 12;
- ndryshime në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) nr. 1, “Huat qeveritare”.

- Ndryshime në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) nr. 1, “Adoptimi për herë të parë i SNRF-ve”.

Tekstet e të cilëve janë bashkëlidhur këtij urdhri dhe janë pjesë integrale e tij .

2. Njësitë ekonomike, të cilat sipas parashikimeve të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe raportimin financiar”, të ndryshuar, janë të detyruara të zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar, të aplikojnë ndryshimet si në pikën 1 të këtij urdhri, duke filluar nga muaji janar 2013.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe në atë të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

**MINISTRI I FINANCIVE**  
**Ridvan Bode**



## Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, Marrëveshjet e Përbashkëta dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Interesat në Njësitë e Tjera: Udhëzues kalimtar

(Ndryshime në  
SNRF 10, SNRF 11 dhe SNRF 12)

### Ndryshime në SNRF 10 *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara*

Në Shtojcën C është shtuar paragrafi C1A.

C1A *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, Marrëveshjet e Përbashkëta dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Interesat në Njësitë e tjera: Udhëzues kalimtar* (Ndryshimet në SNRF 10, SNRF 11 dhe SNRF 12), i publikuar në Qershor 2012, ndryshoi paragrafët C2–C6 dhe shtoi paragrafët C2A–C2B, C4A–C4C, C5A dhe C6A–C6B. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2013 ose më pas. Nëse njësi ekonomike zbaton SNRF 10 për një periudhë më të hershme, ajo duhet të zbatojë këto ndryshime edhe për këtë periudhë.

Në Shtojcën C është ndryshuar paragrafi C2. Teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është shënuar me vijë në mes.

C2 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë SNRF në mënyrë (prapavepruese) retrospektive, në përputhje me SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në (Cmuarjet) Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, me përjashtim të asaj që specifikohet në paragrafët ~~C2~~ C2A–C6.

Në Shtojcën C janë shtuar paragrafët C2A–C2B.

C2A Pavarësisht nga kërkesat e paragrafit 28 të SNK 8, kur ky SNRF zbatohet për herë të parë, një njësi ekonomike duhet të paraqesë vetëm informacionin sasior të kërkuar nga paragrafi 28 (f) i SNK 8 për periudhën vjetore që menjëherë i paraprin dates së zbatimit fillestar të këtij SNRF ("periudha që menjëherë paraprin"). Një njësi ekonomike mund të paraqesë këtë informacion edhe për periudhën aktuale ose për periudhat krahasuese më të hershme, por nuk i kërkohet ta bëjë këtë gjë.

C2B Për qëllime të këtij SNRF, data e zbatimit fillestar është fillimi i periudhës raportuese vjetore për të cilën ky SNRF zbatohet për herë të parë.

Në Shtojcën C janë ndryshuar paragrafët C3–C4. Paragrafi C4 është ndarë në paragrafët C4 dhe C4A. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është shënuar me vijë në mes.

C3 ~~Kur zbatohet për herë të parë ky SNRF në datën e zbatimit fillestar~~, njësisë ekonomike nuk i kërkohet të bëjë rregullime për trajtimin kontabël të mëparshëm për përfshirjen e saj me ose :

- (a) njësitë ekonomike që ~~ishin më parë do të konsolidohen në atë datë~~ në përputhje me SNK 27 *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale* dhe KIS-12 *Konsolidimi—Njësitë Ekonomike për Qëllime të Vecanta* dhe, ~~ende konsolidohen~~ në përputhje me këtë SNRF, ~~vazhdojnë të konsolidohen~~, ose
- (b) njësitë ekonomike që ~~ishin më parë të pakonsoliduara nuk do të konsolidohen në atë datë~~ në përputhje me SNK 27 dhe KIS-12 dhe, ~~nuk janë konsoliduar~~ në përputhje me këtë SNRF, ~~vazhdojnë të mos konsolidohen~~.

C4 ~~Kur zbatimi për herë të parë i këtij SNRF sjell~~ Nëse në datën e zbatimit fillestar, një investitor arrin në përfundimin se duhet të konsolidojë konsolidimin një investim që nuk ishte i konsoliduar në përputhje me SNK 27 dhe KIS-12, investitori duhet:

- (a) nëse i investuari është një biznes (sipas përkufizimit në SNRF 3 *Kombinimet e Biznesit*), të matë aktivet, pasivet dhe interesat jo-kontrolluese në të investuarin e pakonsoliduar më parë ~~në datën e zbatimit fillestar~~ sikur i investuari të ishte konsoliduar (dhe prandaj kishte zbatuar trajtimin kontabël të blerjes në përputhje me SNRF 3) që prej datës kur investitori merr kontrollin e atij të investuari mbi bazën e kërkesave të këtij SNRF. Investitori duhet të rregullojë në mënyrë retrospektive periudhën vjetore që paraprin menjëherë datën e zbatimit fillestar. Nëse data e marrjes së kontrollit është më e hershme se fillimi i periudhës që menjëherë paraprin, investitori do të njohë si një rregullim në kapitalin e vet në fillim të periudhës që menjëherë paraprin, çdo diferencë mes:

- (i) shumës së aktiveve, pasiveve dhe interesave jo-kontrollues të njohur; dhe
- (ii) shumës kontabël të mëparshme që ka përfshirë investitori tek i investuari.

- (b) nëse i investuari nuk është biznes (sipas përkufizimit në SNRF 3), të matë aktivet, pasivet dhe interesat jo-kontrollues në të investuarin e pakonsoliduar më parë ~~në datën e zbatimit fillestar~~ sikur i investuari të kishte qënë konsoliduar (duke zbatuar metodën e blerjes të përcaktuar në SNRF 3 ~~por~~ pa njohur emër të mirë për të investuarin) që nga data kur investitori merr kontrollin e atij të investuari, sipas kërkesave të këtij SNRF. ~~Investitori duhet të rregullojë në mënyrë retrospektive periudhën vjetore që paraprin menjëherë datën e zbatimit fillestar. Nëse data e marrjes së kontrollit është më e hershme se fillimi i periudhës që menjëherë paraprin, investitori duhet të njohë si një rregullim në kapitalin e vet në fillim të periudhës që menjëherë paraprin, një çdo diferencën mes:~~
- (i) shumës së aktiveve, pasiveve dhe interesave jo-kontrollues të njohur; dhe
  - (ii) shumës kontabël të mëparshme që ka përfshirë investitori tek i investuari.
- ~~duhet të njihet si një rregullim korrespondues me tëpricën e çeljes së kapitalit të vet.~~
- ~~(c) Nëse matja e aktiveve, pasiveve ose interesave jo-kontrolluese të të një investuari në përputhje me paragrafin C4(a) ose (b) nuk është e zbatueshme (sipas përkufizimit në SNK 8), një investitori duhet:~~
- ~~(i) nëse i investuari është një biznes të zbatojë, , kërkesat e SNRF 3 siç konsiderohet në datën e blerjes. Data e konsideruar e blerjes do të jetë fillimi i periudhës më të hershme për të cilën është i zbatueshëm SNRF 3 paragrafi C4(a), e cila mund të jetë periudha aktuale.~~
  - ~~(ii) nëse i investuari nuk është një biznes të zbatojë, , metodën e blerjes të përcaktuar në SNRF 3 por pa njohur ndonjë emër të mirë për të investuarin në datën e konsideruar të blerjes. Data e konsideruar e blerjes do të jetë fillimi i periudhës më të hershme për të cilën është i zbatueshëm ky paragrafi C4(b), e cila mund të jetë periudha aktuale.~~
- ~~Investitori do të njohë çdo diferencë mes Investitori do të rregullojë në mënyrë retrospektive periudhën vjetore që paraprin menjëherë datën e zbatimit fillestar, me përjashtim të rastit kur fillimi i periudhës më të hershme për të cilën ky paragrafi është i zbatueshëm, është periudha aktuale. Nëse data e konsideruar e blerjes është më e hershme se fillimi i periudhës që menjëherë paraprin, investitori do të njohë si një rregullim në kapitalin e vet në fillim të periudhës që menjëherë paraprin, çdo diferencë mes:~~
- ~~(c) shumës së aktiveve, pasiveve dhe interesave jo-kontrollues të njohura në datën e konsideruar të blerjes; dhe~~
  - ~~(d) çdo shume të njohur më parë shumës kontabël-së mëparshme nga që ka përfshirë investitori tek i investuari si një rregullim të kapitalit të vet për atë periudhë. Gjithashtu, investitori duhet të japë informacion krahasues dhe shpjegues në përputhje me SNK 8.~~
- ~~Nëse periudha më e hershme për të cilën ky paragrafi është i zbatueshëm, është periudha aktuale, rregullimi në kapitalin e vet do të njihet në fillim të periudhës aktuale.~~

Në Shtojcën C janë shtuar paragrafët C4B–C4C.

- C4B Nëse një investitor zbaton paragrafët C4–C4A dhe nëse data e marrjes së kontrollit sipas këtij SNRF është më vonë se data e hyrjes në fuqi të SNRF 3 të rishikuar në 2008 (SNRF 3 (2008)), referenca ndaj SNRF 3 në paragrafët C4 dhe C4A do të jetë SNRF 3 (2008). Nëse data e marrjes së kontrollit është më parë se data e hyrjes në fuqi e SNRF 3 (2008), investitori duhet të zbatojë ose SNRF 3 (2008) ose SNRF 3 (publikuar në 2004).
- C4C Nëse një investitor zbaton paragrafët C4–C4A dhe nëse data e marrjes së kontrollit sipas këtij SNRF është më vonë se data e hyrjes në fuqi të SNK 27 të rishikuar në 2008 (SNK 27 (2008)), investitori duhet të zbatojë kërkesat e këtij SNRF për të gjitha periudhat në të cilat i investuari është konsoliduar në mënyrë retrospektive në përputhje me paragrafët C4–C4A. Nëse data e marrjes së kontrollit është më parë se data e hyrjes në fuqi e SNK 27 (2008), investitori duhet të zbatojë ose:
- (a) kërkesat e këtij SNRF për të gjitha periudhat në të cilat i investuari është konsoliduar në mënyrë retrospektive në përputhje me paragrafët C4–C4A; ose
  - (b) kërkesat e SNK 27 varianti i publikuar në 2003 (SNK 27 (2003)) për periudhat para datës së hyrjes në fuqi të SNK 27 (2008) dhe më pas kërkesat e këtij SNRF për periudhat vijuese.

Në Shtojcën C janë ndryshuar paragrafët C5–C6. Paragrafi C5 është ndarë në paragrafët C5 dhe C5A. Teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është shënuar me vijë në mes.

- C5 Nëse zbatimi për herë të parë i këtij SNRF sjell Nëse, në datën e zbatimit fillestar, një investitor del në përfundimin se ai nuk do të mos konsolidimin e mëtejshëm konsolidojë më tej të investuarin e konsoliduar



më parë në përputhje me SNK 27 (ndryshuar në 2008) dhe KIS-12, investitori do të matë interesin e ~~pashpërndarë~~ tek i investuari ~~në datën e zbatimit fillestar~~ me shumën me të cilën do të ishte matur nëse kërkesat e këtij SNRF do të ishin në fuqi në kohën kur investitori u përfshi (por nuk mori kontrollin sipas këtij SNRF), ose humbi kontrollin tek i investuari. Investitori duhet të rregullojë në mënyrë retrospektive periudhën vjetore që paraprin menjëherë datën e zbatimit fillestar. Nëse data kur investitori përfshihet (por nuk merr kontrollin sipas këtij SNRF), ose humb kontrollin tek i investuari është më herët se fillimi i periudhës që menjëherë paraprin, investitori duhet të njohë si një rregullim në kapitalin e vet në fillim të periudhës që menjëherë paraprin, çdo diferencë mes:

- (a) shumës kontabël (neto) të mëparshme të aktiveve, pasiveve dhe interesave jo-kontrollues; dhe
- (b) shumës së njohur të interesit të investitorit tek i investuari.

C5A Nëse matja ~~matja~~ e interesit ~~të pashpërndarë~~ tek i investuari në përputhje me paragrafin C5 është e pazbatueshme (siç përkufizohet në SNK 8), një investitor do të zbatojë kërkesat e këtij SNRF ~~për trajtimin kontabël të humbjes së kontrollit~~ në fillim të periudhës më të hershme për të cilën është i mundshëm zbatimi i këtij paragrafi C5, që mund të jetë periudha aktuale. ~~Investitori duhet të njohë çdo diferencë mes~~ Investitori duhet të rregullojë në mënyrë retrospektive periudhën vjetore që menjëherë paraprin datën e zbatimit fillestar, me përjashtim të rastit kur fillimi i periudhës më të hershme për të cilën është i mundshëm zbatimi i këtij paragrafi është periudha aktuale. Nëse data në të cilën investitori përfshihet (por nuk merr kontrollin sipas këtij SNRF), ose humb kontrollin tek i investuari është më herët se fillimi i periudhës që menjëherë paraprin, investitori duhet të njohë si një rregullim në kapitalin e vet në fillim të periudhës që menjëherë paraprin, çdo diferencë mes:

- (a) shumës ~~të njohur më parë~~ kontabël (neto) të mëparshme të aktiveve, pasiveve dhe interesave jo-kontrollues; dhe
- (b) shumës kontabël (neto) së njohur të ~~përfshirjes~~ interesit të investitorit tek i investuari. Si një rregullim të kapitalit të vet për atë periudhë. Gjithashtu, investitori duhet të japë informacion krahasues dhe shpjegues në përputhje me SNK 8.

Nëse periudha më e hershme për të cilën është i zbatueshëm ky paragraf është periudha aktuale, rregullimi në kapitalin e vet do të njihet në fillim të periudhës aktuale.

C6 Paragrafët 23, 25, B94 dhe B96–B99 janë ndryshimet e bëra në 2008 në SNK 27 të mbartura në SNRF 10. Me përjashtim të rastit kur një njësi ekonomike zbaton paragrafin C3, ose i kërket të zbatojë paragrafët C4–C5A, njësi ekonomike duhet të zbatojë kërkesat në këto paragrafe si vijon:

- (a) ...

Në Shtojcën C janë shtuar një titull dhe paragrafët C6A–C6B.

## Referencat ndaj 'periudhës që menjëherë paraprin'

- C6A Pavarësisht nga referencat për periudhën vjetore që menjëherë paraprin datën e zbatimit fillestar ('periudha që menjëherë paraprin') në paragrafët C4–C5A, njësi ekonomike mund të paraqesë edhe informacion krahasues të rregulluar për çdo periudhë më të hershme të paraqitur, por kjo gjë nuk është e detyrueshme. Nëse një njësi ekonomike paraqet informacion krahasues të rregulluar për çdo periudhë më të hershme, të gjitha referencat ndaj 'periudhës që menjëherë paraprin' në paragrafët C4–C5A duhet të lexohen si ndaj 'periudhës më të hershme krahasuese të rregulluar të paraqitur'.
- C6B Nëse një njësi ekonomike paraqet informacion krahasues të parregulluar për çdo periudhë më të hershme, ajo do të identifikojë qartë informacionin e parregulluar, të theksojë që ky informacion është paraqitur mbi një bazë tjetër dhe të shpjegojë këtë bazë.

## Ndryshime në SNRF 11 *Marrëveshjet e Përbashkëta*

Në Shtojcën C janë shtuar paragrafët C1A–C1B.

- C1A *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, Marrëveshjet e Përbashkëta dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Interesat në Njësitë e tjera: Udhëzues kalimtar* (Ndryshimet në SNRF 10, SNRF 11 dhe SNRF 12), i publikuar në Qershor 2012 ndryshoi paragrafët C2–C5, C7–C10 dhe C12 dhe shtoi paragrafët C1B dhe C12A–C12B. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudha vjetore që fillojnë më 1 Janar 2013 ose më pas. Nëse njësi ekonomike zbaton SNRF 11 për një periudhë më të hershme, ajo duhet të zbatojë ndryshimet edhe për këtë periudhë.

### Periudha kalimtare

- C1B Pavarësisht nga kërkesat e paragrafit 28 të SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, kur zbatohet për herë të parë ky SNRF, një njësi ekonomike duhet të paraqesë vetëm informacionin sasior të kërkuar nga paragrafi 28(f) i SNK 8 për periudhën vjetore që menjëherë paraprin periudhën vjetore për të cilën zbatohet SNRF 11 ('periudha që menjëherë paraprin'). Një njësi ekonomike mund të paraqesë këtë informacion edhe për periudhën aktuale ose për periudha krahasuese më të hershme por nuk i kërkohet ta bëjë këtë gjë.

Në Shtojcën C janë ndryshuar paragrafët C2–C5, C7–C10 dhe C12. Teksti I ri është nënvizuar dhe teksti I fshirë është shënuar me vijë në mes.

## Sipërmarrjet e përbashkëta—kalimi nga konsolidimi proporcional tek metoda e kapitalit

- C2 Kur kalon nga metoda e konsolidimit proporcional në metodën e kapitalit, një njësi ekonomike do të njohë investimin e saj në sipërmarrjen e përbashkët që në fillim të periudhës ~~më të hershme që menjëherë paraprin të paraqitur~~. Ky investim fillestar do të matet si shuma e shumave kontabël (neto) të aktiveve dhe pasiveve që njësi ekonomike ka konsoliduar më parë në mënyrë proporcionale, përfshirë çdo emër të mirë të krijuar nga blerja. Nëse emri i mirë më parë i takonte një njësie më të madhe gjeneruese – mjeteve monetare ose një grupi njësisish gjeneruese – të mjeteve monetare, njësi ekonomike duhet të shpërndajë emrin e mirë në sipërmarrjen përbashkët mbi bazën e peshës së vlerës kontabël (neto) të sipërmarrjes së përbashkët dhe njësisë që gjeneron mjete monetare ose grupit të njësisve gjeneruese të mjeteve monetare të cilave u përket.
- C3 Teprica fillestare e investimit e përcaktuar sipas paragrafit C2 shihet si kostoja e konsideruar e investimit në njohjen fillestare. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë paragrafët 40–43 të SNK 28 (ndryshuar në 2011) për tepricën fillestare të investimit për të vlerësuar nëse investimi është çvlerësuar dhe do të njohë çdo humbje nga çvlerësimi si një rregullim të fitimit të pashpërndarë në fillim të periudhës ~~më të hershme që menjëherë paraprin të paraqitur~~. Përgjithësi lidhur me njohjen fillestare në paragrafët 15 dhe 24 të SNK 12 *Tatimi mbi të Ardhurat* nuk zbatohet nëse njësi ekonomike njeh një investim në një sipërmarrje të përbashkët si rezultati i zbatimit të kërkesave kalimtare për sipërmarrjet e përbashkëta të njohur më parë sipas konsolidimit proporcional.
- C4 Nëse bashkimi i të gjithë aktiveve dhe pasiveve të konsoliduara më parë në mënyrë proporcionale rezulton në aktive neto negative, një njësi ekonomike duhet të vlerësojë nëse ka detyrim ligjor ose konstruktiv në lidhje me aktivet neto negative dhe nëse është kështu, njësi ekonomike duhet të njohë pasivin korrespondues. Nëse njësi ekonomike del në përfundimin që nuk ka detyrime ligjore ose konstruktive lidhur me aktivet neto negative, ajo nuk do të njohë pasivin korrespondues por do të rregullojë fitimet e pashpërndara në fillim të periudhës ~~më të hershme që menjëherë paraprin të paraqitur~~. Njësi ekonomike do të japë informacion shpjegues për këtë fakt së bashku me pjesën e akumuluar e të panjohur të humbjes në sipërmarrjet e saj të përbashkëta në fillim të periudhës ~~më të hershme që menjëherë paraprin të paraqitur~~ dhe në datën kur ky SNRF zbatohet për herë të parë.
- C5 Një njësi ekonomike do të paraqesë në shënimet shpjeguese një analizë për aktivet dhe pasivet që janë bashkuar në një zë të vetëm tepricë investimi në fillim të periudhës ~~më të hershme që menjëherë paraprin të paraqitur~~. Kjo dhënie informacionesh shpjeguese duhet të përgatitet në mënyrë përmbljedhëse për të gjitha sipërmarrjet e përbashkëta, për të cilat njësi ekonomike zbaton kërkesat kalimtare të cilësuar në paragrafët C2–C6.



C6 ...

### Operacionet e përbashkëta—kalimi nga metoda e kapitalit tek trajtimi kontabël i aktiveve dhe pasiveve

- C7 Kur kalon nga metoda e kapitalit tek trajtimi kontabël i aktiveve dhe pasiveve në lidhje me interesat e veta në një operacion të përbashkët, një njësi ekonomike në fillim të periudhës ~~më të hershme që menjëherë paraprin të paraqitur~~ do të ç'regjistrojë investimin që më parë është trajtuar sipas metodës së kapitalit dhe çdo zë tjetër që bënte pjesë në investimin neto të njësisë ekonomike në marrëveshje sipas paragrafit 38 të SNK 28 (ndryshuar në 2011), do të njohë pjesën e saj në secilin prej aktiveve dhe pasiveve të lidhura me interesin e saj në operacionin e përbashkët, përfshirë çdo emër të mirë që mund të ketë qenë pjesë e vlerës kontabël (neto) të investimit.
- C8 Një njësi ekonomike do të përcaktojë interesin e saj në aktivet dhe pasivet e lidhura me operacionin e përbashkët mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të saj në raportin e përcaktuar në përputhje me marrëveshjen kontraktuale. Një njësi ekonomike mat vlerat kontabël (neto) fillestare të aktiveve dhe pasiveve duke i nxjerrë (ndarë) këto vlera nga vlera kontabël (neto) e investimit në fillim të periudhës ~~më të hershme që menjëherë paraprin të paraqitur~~ bazuar në informacionin e përdorur nga njësi ekonomike në zbatimin e metodës së kapitalit.
- C9 Çdo diferencë që vjen nga investimi i trajtuar më parë me metodën e kapitalit së bashku me çdo zë tjetër që bënte pjesë në investimin neto të njësisë ekonomike në marrëveshje sipas paragrafit 38 të SNK 28 (ndryshuar në 2011) dhe shuma neto e aktiveve dhe pasiveve të njohura, përfshirë çdo emër të mirë, do të:
- (a) kompensohet kundrejt emrit të mirë që lidhet me investimin dhe çdo diferencë e mbetur e rregulluar në fitimet e pashpërndara në fillim të periudhës ~~më të hershme që menjëherë paraprin të paraqitur~~ nëse shuma neto e aktiveve dhe pasiveve të njohura, përfshirë çdo emër të mirë, është më e madhe se investimi i ç'regjistruar (dhe çdo zë tjetër që mund të ketë qenë pjesë e investimit neto të njësisë ekonomike).
  - (b) rregullohet kundrejt fitimit të pashpërndarë në fillim të periudhës ~~më të hershme që menjëherë paraprin të paraqitur~~ nëse shuma neto e aktiveve dhe pasiveve të njohura, përfshirë çdo emër të mirë, është më e vogël se investimi i ç'regjistruar (dhe çdo zë tjetër që mund të ketë qenë pjesë e investimit neto të njësisë ekonomike).
- C10 Një njësi ekonomike që kalon nga metoda e kapitalit në metodën e aktiveve dhe pasiveve duhet të bëjë një rakordim të investimit të ç'regjistruar dhe aktiveve dhe pasiveve të njohura, së bashku me çdo diferencë të mbetur të rregulluar kundrejt fitimit të pashpërndarë në fillim të periudhës ~~më të hershme që menjëherë paraprin të paraqitur~~.
- C11 ...

### Dispozita kalimtare në pasqyrat financiare individuale të një njësie ekonomike

- C12 Një njësi ekonomike, e cila në përputhje me paragrafin 10 të SNK 27 në pasqyrat financiare individuale më parë trajtonte interesat e saj në një operacion të përbashkët si një investim me kosto ose në përputhje me SNRF 9 do të:
- (a) ç'regjistrojë investimin dhe do të njohë aktivet dhe pasivet e lidhura me interesin e saj në operacionin e përbashkët me shumën e përcaktuar sipas paragrafëve C7–C9.
  - (b) bëjë një rakordim të investimit të ç'regjistruar dhe të aktiveve dhe pasiveve të njohura, së bashku me çdo diferencë të mbetur e të rregulluar në fitimin e pashpërndarë, në fillim të periudhës ~~më të hershme që menjëherë paraprin të paraqitur~~.

Në Shtojcën C janë shtuar një titull dhe paragrafët C12A–C12B.

### Referencat ndaj 'periudhës që menjëherë paraprin'

- C12A Pavarësisht nga referencat për 'periudhën që menjëherë paraprin' në paragrafët C2–C12, një njësi ekonomike mund të paraqesë edhe informacion krahasues të rregulluar për çdo periudhë më të hershme të paraqitur, por kjo gjë nuk është e detyrueshme. Nëse një njësi ekonomike paraqet informacion krahasues të

rregulluar për çdo periudhë më të hershme, të gjitha referencat ndaj 'periudhës që menjëherë paraprind' në paragrafët C2-C12 duhet të lexohen si ndaj 'periudhës më të hershme krahasuese të rregulluar të paraqitur'.

- C12B Nëse një njësi ekonomike paraqet informacion krahasues të parregulluar për çdo periudhë më të hershme, ajo do të identifikojë qartë informacionin e parregulluar, të theksojë që ky informacion është paraqitur mbi një bazë tjetër dhe të shpjegojë këtë bazë.

## **Ndryshime në SNRF 11 *Marrëveshjet e Përbashkëta*** **Ndryshim për pasojë në SNRF 1 *Zbatimi për herë të parë i Standardeve*** ***Ndërkombëtare të Raportimit Financiar***

Kjo shtojcë paraqet ndryshimin në SNRF 1 *Zbatimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar* që vjen si pasojë e publikimit nga Bordi të ndryshimeve në SNRF 11 *Marrëveshjet e Përbashkëta*. Paragrafi i ndryshuar paraqitet me tekstin e ri të nënvizuar dhe tekstin e fshirë të shënuar me vijë në mes. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 1.

## **SNRF 1 *Zbatimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të*** ***Raportimit Financiar***

Është shtuar paragrafi 39S.

- 39S *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, Marrëveshjet e Përbashkëta dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Interesat në Njësitë e Tjera: Udhëzues kalimtar* (Ndryshimet në SNRF 10, SNRF 11 dhe SNRF 12), i publikuar në Qershor 2012 ndryshoi paragrafin D31. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë ndryshim kur zbaton SNRF 11 (të ndryshuar në Qershor 2012).

Në Shtojcën D është ndryshuar paragrafi D31. Teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është shënuar me vijë në mes.

## **Marrëveshjet e përbashkëta**

- D31 Një zbatues për herë të parë mund të zbatojë dispozitat kalimtare të SNRF 11 me përjashtimet në vijim:-

- (a) Kur zbatohen dispozitat kalimtare të SNRF 11, një zbatues për herë të parë duhet të zbatojë këto dispozita në datën e kalimit në SNRF.
- (b) Kur kalohet nga konsolidimi përpjestimor në metodën e kapitalit, një zbatues për herë të parë duhet të testojë për çvlerësim investimin në përputhje me SNK 36 në fillim të periudhës më të hershme të paraqitur datën e kalimit në SNRF, pavarësisht nëse ka ose jo ndonjë tregues që investimi mund të jetë çvlerësuar. Çdo çvlerësim që rezulton duhet të njihet si një rregullim i fitimit të pashpërndarë në fillim të periudhës më të hershme të paraqitur datën e kalimit në SNRF.



### **Ndryshim në SNRF 12 *Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Interesat në Njësitë e Tjera***

Në Shtojcën C janë shtuar paragrafët C1A dhe C2A–C2B.

- C1A *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, Marrëveshjet e Përbashkëta dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Interesat në Njësitë e Tjera: Udhëzues kalimtar* (Ndryshimet në SNRF 10, SNRF 11 dhe SNRF 12), i publikuar në Qershor 2012 shtoi paragrafët C2A–C2B. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudha vjetore që fillojnë më 1 Janar 2013 ose më pas. Nëse njësi ekonomike zbaton SNRF 12 për një periudhë më të hershme, ajo duhet të zbatojë këto ndryshime edhe për atë periudhë.
- C2 ...
- C2A Nuk është e nevojshme që kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të këtij SNRF të zbatohen për periudha që fillojnë më parë se periudha vjetore që paraprin menjëherë periudhën e parë vjetore për të cilën zbatohet SNRF 12.
- C2B Nuk është e nevojshme që kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të paragrafëve 24–31 dhe udhëzuesi korrespondues në paragrafët B21–B26 e këtij SNRF, të zbatohen për periudha që fillojnë më parë se periudha e parë vjetore për të cilën zbatohet SNRF 12.

## Huatë qeveritare (Ndryshime në SNRF 1)

### **Ndryshime në SNRF 1 *Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Herë të Parë***

Janë shtuar paragrafët 39N dhe 39O dhe është ndryshuar paragrafi B1 (teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është shënuar me vijë në mes).

- 39N *Huatë Qeveritare* (Ndryshime në SNRF 1), i publikuar në Mars 2012, shtoi paragrafët B1(f) dhe B10–B12. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto paragrafë për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2013 ose më pas. Lejohet zbatimi më i hershëm.
- 39O Paragrafët B10 dhe B11 i referohen SNRF 9. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë SNRF por ende nuk zbaton SNRF 9, referencat në paragrafët B10 dhe B11 të SNRF 9 duhet të lexohen si referenca të SNK 39 *Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja*.
- B1 Një njësi ekonomike do të zbatojë përjashtimet në vijim:
- (a) Mosnjohjen e aktiveve dhe pasiveve financiare (paragrafët B2 dhe B3);
  - (b) Kontabilitetin mbrojtës (paragrafët B4–B6);
  - (c) Interesat jo-kontrolluese (paragrafi B7);
  - (d) Klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare (paragrafi B8); ~~dhe~~
  - (e) Derivatitë e përfshirë (paragrafi B9); ~~dhe~~
  - (f) Huatë qeveritare (paragrafët B10–B12).

Pas paragrafit B9 janë shtuar një titull dhe paragrafët B10–B12.

### **Huatë qeveritare**

- B10 Një zbatues për herë të parë duhet të klasifikojë si pasiv financiar ose si një instrument kapitali të gjitha huatë qeveritare të marra, në përputhje me SNK 32 *Instrumentat Financiarë: Paraqitja*. Me përjashtim të rastit të përcaktuar në paragrafin B11, një zbatues për herë të parë duhet të zbatojë të gjitha kërkesat e SNRF 9 *Instrumentat Financiarë* dhe SNK 20 *Kontabiliteti për Grantet Qeveritare dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Ndihmën qeveritare*, në mënyrë prospektive për huatë qeveritare ekzistuese në datën e kalimit në SNRF dhe nuk duhet të njohë si grant qeveritar përfitimin korrespondues të huasë qeveritare me normë interesi më të ulët se tregu. Gjithashtu, nëse një zbatues për herë të parë nuk ka njohur dhe nuk ka matur mbi baza të përputhshme me kërkesat e IFRS-ve, sipas standardeve të mëparshme, një hua qeveritare me normë interesi më të ulët se tregu, duhet të përdorë vlerën kontabël të huasë sipas standardeve të mëparshme në datën e kalimit në SNRF si vlerë kontabël të huasë në pasqyrën e çeljes së gjendjes financiare sipas SNRF-ve.



Njësia ekonomike duhet të zbatojë SNRF 9 për matjen e huave të tilla pas datës së kalimit në SNRF.

- B11 Pavarësisht nga paragrafi B10, një njësi ekonomike mund të zbatojë kërkesat e SNRF 9 dhe SNK 20 në mënyrë retrospektive për çdo hua qeveritare të krijuar para datës së kalimit në SNRF, me kushtin që informacioni i nevojshëm për ta realizuar këtë të jetë marrë në kohën e trajtimit fillestar kontabël të huasë.
- B12 Kërkesat dhe udhëzuesi në paragrafët B10 dhe B11 nuk pengojnë një njësi ekonomike që të përdorë përjashtimet e përshkruara në paragrafët D19–D19D lidhur me përcaktimin e instrumentave financiarë të njohur më parë, me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

## Ndryshim në SNRF 1 *Adoptimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar*

Janë shtuar paragrafët 4A-4B, 23- 23B dhe-39P.

### Objekti

- 4A Pavarësisht nga kërkesat në paragrafët 2 dhe 3, një njësi ekonomike që ka zbatuar SNRF-të në periudhat e mëparshme raportuese, por që pasqyrat financiare vjetore më të fundit të mëparshme nuk përmbajnë një pohim të qartë dhe pa rezerva të pajtueshmërisë me SNRF-të, ose duhet të zbatojë këtë SNRF ose përndryshe të zbatojë SNRF-të në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 *Politikat Kontabël, ndryshimet në vlerësimet dhe gabimet*, sikur njësia ekonomike të mos e kishte ndërprerë kurrë zbatimin e SNRF-ve.
- 4B Kur një njësi ekonomike nuk zgjedh të zbatojë këtë SNRF në përputhje me paragrafin 4A, njësia ekonomike do të zbatojë gjithsesi kërkesat në paragrafët 23A-23B të SNRF 1 për dhënie informacionesh shpjeguese, përveç kërkesave për dhënie informacionesh shpjeguese në SNK 8.

### Paraqitja dhe dhënia e informacioneve shpjeguese

#### Shpjegimi i kalimit në SNRF-të

- 23A Një njësi ekonomike që ka zbatuar SNRF-të në një periudhë të mëparshme, siç përshkruhet në paragrafin 4A, duhet të japë:
- (a) arsyen pse ajo ka ndërprerë zbatimin e SNRF-ve; dhe
  - (b) arsyen pse ajo ka rinisur zbatimin e SNRF-ve.
- 23B Kur një njësi ekonomike, në përputhje me paragrafin 4A, nuk zgjedh të zbatojë SNRF 1, njësia ekonomike do të shpjegojë arsyet e zgjedhjes për të zbatuar SNRF-të sikur ajo të mos e kishte ndërprerë zbatimin e SNRF-ve.

### Data e hyrjes në fuqi

- 39P *Cikli i përmirësimeve vjetore 2009-2011*, i publikuar në maj 2012, shtoi paragrafët 4A-4B dhe 23A-23B. Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet* për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë ndryshim për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.



## **Ndryshim në shtojcën D të SNRF 1 *Adoptimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar***

Paragrafi D23 është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është me një vizë që i kalon mes përmes) dhe është shtuar paragrafi 39Q.

### **Kostot e huamarrjes**

D23 Një adoptues për herë të parë mund të zbatojë dispozitat kalimtare të përcaktuara në paragrafët 27 dhe 28 të SNK 23, të rishikuar në vitin 2007. Në këto paragrafe, referenca në datën e hyrjes në fuqi duhet të interpretohet si 1 janar 2009 ose data e kalimit në SNRF, cila prej tyre është më e fundit. Një adoptues për herë të parë mund të zgjedhë të zbatojë kërkesat e SNK 23 nga data e kalimit apo nga një datë më e hershme, siç lejohet nga paragrafi 28 i SNK 23. Nga data në të cilën një njësi ekonomike, që zbaton këtë përjashtim, fillon të zbatojë SNK 23, njësi ekonomike:

- (a) nuk do ta riparagesë përbërësin e kostos së huamarrjes që është kapitalizuar sipas PPPK-ve të mëparshme dhe që është përfshirë në vlerën kontabël të aktiveve në këtë datë, dhe;
- (b) do të riparagesë kostot e huamarrjes të kryera në këtë datë ose në vijim në përputhje me SNK 23, duke përfshirë edhe ato kosto të huamarrjes të shkaktuara në ose pas kësaj date në aktivet e kualifikuara tashmë në ndërtim e sipër.

### **Data e hyrjes në fuqi**

39Q Cikli i përmirësimeve vjetore 2009-2011, i publikuar në maj 2012, ndryshoi paragrafin D23. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet* për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë ndryshim për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

## **Ndryshim në SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare***

Paragrafët 10, 38 dhe 41 janë ndryshuar. Paragrafët 39 dhe 40 janë fshirë. Janë shtuar paragrafët 38A-38D, 40D 40A-dhe 139L (edhe pse përmbajtja e paragrafëve 38A dhe 38B është e bazuar në paragrafët 39 dhe 40 të mëparshëm, që tani janë fshirë), si dhe titujt para paragrafët 38C dhe 38, 40A. Teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është me një vizë që i kalon mes përmes.

### **Paketa e plotë e pasqyrave financiare**

- 10 Një paketë e plotë e pasqyrave financiare përmban:
- (a) një pasqyrë të pozicionit financiar në fund të periudhës;
  - (b) një pasqyrë të fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera të përgjithshme për periudhën;
  - (c) një pasqyrë të ndryshimeve në kapital për periudhën;
  - (d) një pasqyrë të flukseve të mjeteve monetare për periudhën;
  - (e) shënimet, që përfshijnë një përmbledhje të politikave kontabël të rëndësishme dhe shënime të tjera shpjeguese; dhe
  - (ea) informacion krahasues në lidhje me periudhën e mëparshme, siç është specifikuar në paragrafët 38 dhe 38A; dhe
  - (f) një pasqyrë të pozicionit financiar në fillim të periudhës ~~me të~~ hershme krahasuese së mëparshme kur një njësi ekonomike zbaton një politikë kontabël në mënyrë retrospektive, ose bën një riparaqitje retrospektive të zërave në pasqyrat e saj financiare, apo kur ajo riklasifikon zërat në pasqyrat e saj financiare në përputhje me paragrafët 40A-40D.

Një njësi ekonomike mund të përdorë emërtime të ndryshme për pasqyrat nga ato të përdorura në këtë standard. Për shembull, një njësi ekonomike mund të përdorë emërtimin 'pasqyra e të ardhurave të përgjithshme' në vend të 'pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera të përgjithshme'.



## Informacioni krahasues

### Informacioni krahasues minimal

- 38 Me përjashtim të rastit kur SNRF-të lejojnë ose kërkojnë të kundërtën, një njësi ekonomike do të ~~japë informacion shpjegues~~ paraqesë informacion krahasues në lidhje me periudhën ~~e mëparshme e shkuar~~ për të gjitha shumatat e raportuara në pasqyrat financiare të periudhës aktuale. Një njësi ekonomike do të përfshijë informacionin krahasues në formën e informacionit tregues dhe përshkrues, ~~kur~~ nëse informacioni është i rëndësishëm për të kuptuar pasqyrat financiare të periudhës aktuale.
- 38A Një njësi ekonomike duhet të paraqesë, minimalisht, dy pasqyra të pozicionit financiar, dy pasqyra të fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera të përgjithshme, dy pasqyra të veçanta të fitimit ose humbjes (nëse paraqiten), dy pasqyra të flukseve të mjeteve monetare dhe dy pasqyra të ndryshimeve në kapital, si dhe shënimet përkatëse.
- 38B Në disa raste, informacioni tregues i dhënë në pasqyrat financiare për periudhën (periudhat) e shkuar vazhdon të jetë i rëndësishëm në periudhën aktuale. Për shembull, një njësi ekonomike jep informacion shpjegues të hollësishëm, në periudhën aktuale, për një mosmarrëveshje ligjore, rezultati i të cilës ishte i pasigurt në fund të periudhës së shkuar dhe është ende për t'u zgjidhur. Përdoruesit mund të përfitojnë nga dhënia e informacionit për faktin se pasiguria ekzistonte në fund të periudhës së shkuar dhe nga dhënia e informacionit në lidhje me hapat që janë marrë gjatë periudhës për të zgjidhur pasigurinë.

### Informacion krahasues shtesë

- 38C Një njësi ekonomike mund të paraqesë informacion krahasues shtesë përveç minimumit të kërkuar për pasqyrat financiare krahasuese nga SNRF-të, për aq kohë sa ky informacion është përgatitur në përputhje me SNRF-të. Ky informacion krahasues mund të përbëhet nga një ose më shumë pasqyra të përmendura në paragrafin 10, por nuk duhet të përmbajë një paketë të plotë të pasqyrave financiare. Në një rast të tillë, njësi ekonomike do të paraqesë informacion në formën e shënimeve lidhur me këto pasqyra shtesë.
- 38D Për shembull, një njësi ekonomike mund të paraqesë një pasqyrë të tretë të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera të përgjithshme (duke paraqitur periudhën aktuale, periudhën e shkuar dhe një periudhë shtesë krahasuese). Megjithatë, njësi ekonomike nuk kërkohet të paraqesë një pasqyrë të tretë të pozicionit financiar, një pasqyrë të tretë të flukseve të mjeteve monetare ose një pasqyrë të tretë të ndryshimeve në kapitalin neto (dmth. një pasqyrë shtesë financiare krahasuese). Njësi ekonomike

kërkohej të paraqesë në shënimet e pasqyrave financiare, informacionin krahasues në lidhje me këtë pasqyrë shtesë të fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera të përgjithshme.

39 ~~[Fshirë] Një njësi ekonomike gjatë dhënies së informacionit krahasues do të paraqesë, minimalisht, dy pasqyra të pozicionit financiar, dy nga secilën prej pasqyrave të tjera, si dhe shënimet përkatëse. Kur një njësi ekonomike zbaton një politikë kontabël në mënyrë retrospektive, ose bën një riparaqitje në retrospektivë të zërave në pasqyrat e saj financiare ose kur riklasifikon zërat në pasqyrat e saj financiare, ajo do të paraqesë, minimalisht, tri pasqyra të pozicionit financiar, dy nga secilën prej pasqyrave të tjera, dhe shënimet përkatëse. Një njësi ekonomike paraqet pasqyrën e pozicionit financiar:~~

- (a) ~~në fund të periudhës aktuale;~~
- (b) ~~në fund të periudhës së mëparshme (që është e njëjtë me fillimin e periudhës aktuale), dhe~~
- (c) ~~në fillim të periudhës krahasuese më të hershme.~~

40 ~~[Fshirë] Në disa raste, informacioni tregues i dhënë në pasqyrat financiare për periudhën e mëparshme (periudhat) vazhdon të jetë i rëndësishëm në periudhën aktuale. Për shembull, një njësi ekonomike jep informacion shpjegues të hollësishëm në periudhën aktuale për një mosmarrëveshje ligjore, rezultati i të cilës ishte i pasigurt në fund të periudhës raportuese të shkuar dhe që është ende për t'u zgjidhur. Përdoruesit përfitojnë nga informacioni në lidhje me faktin që ekzistonte pasiguria në fund të periudhës raportuese të shkuar, si dhe për hapat që janë ndërmarrë gjatë periudhës për të zgjidhur pasigurinë.~~

#### **Ndryshim në politikën kontabël, riparaqitja retrospektive apo riklasifikimi**

40A Një njësi ekonomike do të paraqesë një pasqyrë të tretë të pozicionit financiar në fillim të periudhës së shkuar, përveç pasqyrave financiare krahasuese minimale që kërkohej në paragrafin 38A, nëse:

- (a) zbaton një politikë kontabël në mënyrë retrospektive, bën një riparaqitje retrospektive të zërave në pasqyrat e saj financiare ose riklasifikon zërat në pasqyrat e saj financiare; dhe
- (b) zbatimi retrospektiv, riparaqitja retrospektive ose riklasifikimi ka një efekt material në informacionin e pasqyrës së pozicionit financiar në fillim të periudhës së shkuar.

40B Në rrethanat e përshkruara në paragrafin 40A, një njësi ekonomike do të paraqesë tri pasqyra të pozicionit financiar:

- (a) në fund të periudhës aktuale;
- (b) në fund të periudhës së shkuar; dhe
- (c) në fillim të periudhës së shkuar.



- 40C Kur një njësi ekonomike kërkohet të paraqesë një pasqyrë shtesë të pozicionit financiar, në përputhje me paragrafin 40A, ajo duhet të japë informacionin shpjegues të kërkuar nga paragrafët 41-44 dhe SNK 8. Megjithatë, nuk është e nevojshme të paraqesë shënimet lidhur me çeljen e pasqyrës së pozicionit financiar në fillimin e periudhës së shkuar.
- 40D Data e çeljes e kësaj pasqyre të pozicionit financiar do të jetë e njëjtë me fillimin e periudhës së shkuar, pavarësisht nga fakti nëse pasqyrat financiare të një njësie ekonomike paraqesin informacion krahasues për periudhat më të hershme (lejuar në paragrafin 38C).
- 41 ~~Kur~~ Nëse një njësi ekonomike ndryshon paraqitjen ose klasifikimin e zërave në pasqyrat e saj financiare, ~~njësia ekonomike~~ ajo do të riklasifikojë shumat krahasuese përveç rastit kur riklasifikimi është i pazbatueshëm. Kur një njësi ekonomike riklasifikon shumat krahasuese, ~~njësia ekonomike~~ ajo jep informacion shpjegues (duke përfshirë dhe fillimin e periudhës së shkuar):
- (a) natyrën e riklasifikimit;
  - (b) shumën e çdo zëri ose klase që është riklasifikuar; dhe
  - (c) arsyen për riklasifikimin.

## **Periudha kalimtare dhe data e hyrjes në fuqi**

- 139L Cikli i përmirësimeve vjetore 2009-2011, i publikuar në maj 2012, ndryshoi paragrafët 10, 38 dhe 41, fshiu paragrafët 39-40 dhe shtoi paragrafët 38A-38D dhe 40A-40D. Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet* për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë ndryshim për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

## Ndryshimet pasuese në standardet e tjera që rrjedhin nga ndryshimi në SNK 1

*Ndryshimet e mëposhtme në SNRF-të e tjera janë të nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë me SNK 1 e rishikuar.*

### **Ndryshim në SNRF 1 *Adoptimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar***

Paragrafi 21 është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është me një vizë që kalon mes përmes) dhe është shtuar paragrafi 39R.

### **Paraqitja dhe dhënia e informacioneve shpjeguese**

#### **Informacioni krahasues**

- 21 ~~Në përputhje me SNK 1, një~~ Pasqyrat financiare të një njësie ekonomike, që janë ndërtuar për herë të parë sipas SNRF-ve, do të përfshijnë të paktën tri pasqyra të pozicionit financiar, dy pasqyra të fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera të përgjithshme, dy pasqyra të veçanta të fitimit ose humbjes (nëse paraqiten), dy pasqyra të flukseve të mjeteve monetare dhe dy pasqyra të ndryshimeve në kapitalin neto dhe shënimet përkatëse, duke përfshirë informacionin krahasues për të gjitha pasqyrat e paraqitura.

### **Data e hyrjes në fuqi**

- 39R *Cikli i përmirësimeve vjetore 2009-2011, i publikuar në maj 2012, ndryshoi paragrafin D23. Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë ndryshim për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.*



## Ndryshimet pasuese në standardet e tjera që rrjedhin nga ndryshimi në SNK 1 (në vazhdim)

### Ndryshim në SNK 34 Raportimi Financiar i Ndërmjetëm

Paragrafi 5 është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është me një vizë që i kalon mes përmes) dhe është shtuar paragrafi 52.

### Përmbajtja e një raporti financiar të ndërmjetëm

- 5 SNK 1 (~~i rishikuar në 2007~~) përcakton një paketë të plotë të pasqyrave financiare me përfshirjen e përbërësve në vijim:
- (a) një pasqyrë e pozicionit financiar në fund të periudhës;
  - (b) një pasqyrë e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera të përgjithshme për periudhën;
  - (c) një pasqyrë e ndryshimeve në kapitalin neto për periudhën;
  - (d) një pasqyrë të flukseve të mjeteve monetare për periudhën;
  - (e) shënimet, që përfshijnë një pëmbledhje të politikave kontabël të rëndësishme dhe shënime të tjera shpjeguese; ~~dhe~~
  - (ea) informacion krahasues në lidhje me periudhën e shkuar, siç është specifikuar në paragrafët 38 dhe 38A të SNK 1; dhe
  - (f) një pasqyrë të pozicionit financiar në fillim të periudhës ~~me të hershme krahasuese~~ së shkuar kur një njësi ekonomike zbaton një politikë kontabël në mënyrë retrospektive, ose bën një riparaqitje retrospektive të zërave në pasqyrat e saj financiare, apo kur ajo riklasifikon zërat në pasqyrat e saj financiare në përputhje me paragrafët 40A-40D të SNK 1.

Një njësi ekonomike mund të përdorë emërtime të ndryshme për pasqyrat nga ato të përdorura në këtë standard. Për shembull, një njësi ekonomike mund të përdorë emërtimin 'pasqyra e të ardhurave përgjithshme' në vend të 'pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera të përgjithshme'.

## Ndryshimet pasuese në standardet e tjera që rrjedhin nga ndryshimi në SNK 1 (në vazhdim)

### Data e hyrjes në fuqi

- 52 Cikdi i përmirësimeve vjetore 2009-2011, i publikuar në maj 2012, ndryshoi paragrafin 5 si një ndryshim pasues si rrjedhim i ndryshimit në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave financiare. Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë ndryshim për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

## **Ndryshimi në SNK 16 Aktivët afatgjatë materiale (toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje)**

Paragrafi 8 është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është me një vizë që kalon mes përmes) dhe është shtuar paragrafi 81G.

### **Njohja**

- 8      Zëra të tillë si pjesët e ndërrimit, pajisjet rezervë dhe pajisjet e shërbimit njihen në përputhje me këtë SNRF mbarten si inventar dhe njihen në fitim ose humbje kur konsumohen. Megjithatë, shumica e pjesëve të ndërrimit, dhe pajisjet rezervë kualifikohen si aktive afatgjatë materiale (toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje) kur ato plotësojnë përkufizimin e aktiveve afatgjatë materiale (toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje). Në të kundërt, zëra të tillë klasifikohen si inventarë, një njësi ekonomike pret t'i përdorë ato në më shumë se një periudhë. Në mënyrë të ngjashme, nëse pjesët e ndërrimit dhe pajisjet e shërbimit mund të përdoren vetëm në lidhje me një zë të aktiveve afatgjatë materiale (toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje), ato trajtohen si aktive afatgjatë materiale (toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje).

### **Data e hyrjes në fuqi**

- 81G      Cikli i përmirësimeve vjetore 2009-2011, i publikuar në maj 2012, ndryshoi paragrafin 8. Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 Politikën kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë ndryshim për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.



## **Ndryshim në SNK 32 Instrumentet financiare: Paraqitja**

Paragrafët 35, 37 dhe 39 janë ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është me një vizë që i kalon mes përmes) dhe janë shtuar paragrafët 35A dhe 97M.

### **Paraqitja**

#### **Interesat, dividendët, humbjet dhe fitimet neto (shih gjithashtu paragrafin UZ37)**

- 35 Interesi, dividendët, humbjet dhe fitimet neto në lidhje me një instrument financiar ose një përbërës që është një pasiv financiar do të njihen si e ardhur ose si shpenzim në fitimin ose humbjen neto. Shpërndarjet tek zotëruesit e një instrumenti të kapitalit neto do të njihen ~~debitohen~~ nga njësia ekonomike drejtpërdrejt në kapitalin neto, ~~neto nga çdo përfitim i tatimit mbi të ardhurat të lidhur me të~~. Kostot e transaksionit të një transaksioni të kapitalit neto do të kontabilizohen si një zbritje nga kapitali neto, ~~neto nga çdo përfitim i tatimit mbi të ardhurat të lidhur me të~~.
- 35A Tatimi mbi të ardhurat që lidhet me shpërndarjet tek zotëruesit e një instrumenti të kapitalit neto dhe kostot e transaksionit të një transaksioni të kapitalit neto do të kontabilizohet në përputhje me SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat.
- 37 Një njësi ekonomike në mënyrë tipike kryen kosto të ndryshme në emetimin ose blerjen e instrumenteve të kapitalit neto të vet. Këto kosto mund të përfshijnë tarifën e regjistrimit dhe tarifën e tjera rregullatore, shumën e paguar për këshilltarët ligjorë, kontabël dhe profesionistë të tjerë, kostot e shtypshkrimit dhe taksat e pullës. Kostot e transaksionit të një transaksioni të kapitalit neto kontabilizohen si një zbritje nga kapitali neto ~~(neto nga çdo përfitim i lidhur i tatimit mbi të ardhurat)~~ për aq sa ato janë kosto rritëse drejtpërdrejt të ngarkueshme në transaksionin e kapitalit neto, që në të kundërtën do të ishin shmangur. Kostot e një transaksioni të kapitalit neto që është abandonuar njihen si shpenzim.
- 39 Shuma e kostove të transaksionit e kontabilizuar si një zbritje nga kapitali neto gjatë periudhës jepet në informacionet shpjeguese veçmas ~~sipas në përputhje me SNK 1~~. Shuma e lidhur me tatimet mbi të ardhurat, e njohur drejtpërdrejt në kapitalin neto, përfshihet në shumën totale të tatimit mbi të ardhurat aktuale me ato të shtyra, e kredituar ose e regjistruar në kapitalin neto, që jepet në informacionet shpjeguese sipas SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat.

### **Data e hyrjes në fuqi dhe periodha kalimtare**

- 97M Cikli i përmirësimeve vjetore 2009-2011, i publikuar në maj 2012, ndryshoi paragrafët 35, 37 dhe 39 dhe shtoi paragrafin 35A. Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë ndryshim për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

## **Ndryshimet pasuese në standardet e tjera që rrjedhin nga ndryshimi në SNK 32**

*Ndryshimet e mëposhtme në SNRF-të e tjera janë të nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë me SNK 32 e rishikuar.*

### **Ndryshim në KIRFN 2 Aksionet e anëtarëve të njëjësive ekonomike të tipit kooperativë dhe instrumente të ngjashëm**

Paragrafi 11 është ndryshuar (teksti i fshirë është me një vizë që i kalon mes përmes) dhe është shtuar paragrafi 17.

## **Konsensusi**

- 11 Siç kërkohet nga paragrafi 35 i SNK 32, shpërndarjet tek zotëruesit e instrumenteve të kapitalit neto njihen drejtpërdrejt në kapitalin neto, ~~neto nga çdo përfitim i lidhur i tatimit mbi të ardhurat~~. Interesi, dividendët dhe kthimet e tjera që lidhen me instrumentet financiare të klasifikuara si pasive financiare janë shpenzime, pavarësisht nga fakti nëse këto shuma të paguara karakterizohen ligjërisht si dividendë, interesa ose ndryshe.

## **Data e hyrjes në fuqi**

- 17 Cikli i përmirësimeve vjetore 2009-2011, i publikuar në maj 2012, ndryshoi paragrafin 11. Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë ndryshim në SNK 32 para kësaj date, si një pjesë e Ciklit të përmirësimeve vjetore 2009-2011 (të publikuar në maj 2012), edhe ndryshimi në paragrafin 11 do të zbatohet para kësaj date..



## **Ndryshim në SNK 34 Raportimi financiar i ndërmjetëm**

Paragrafi 16 është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është me një vizë që i kalon mes përmes) dhe është shtuar paragrafi 53.

## **Përmbajtja e një raporti financiar të ndërmjetëm**

### **Dhënia e informacioneve të tjera shpjeguese**

16A Përveç dhënies së informacioneve shpjeguese për ngjarje dhe transaksione të rëndësishme në përputhje me paragrafët 15-15C, një njësi ekonomike do të përfshijë informacionin e mëposhtëm në shënimet e pasqyrave financiare të ndërmjetme të saj, nëse nuk është paraqitur diku tjetër në raportin financiar të ndërmjetëm. Normalisht, informacioni do të raportohet që nga fillimi i vitit financiar deri në momentin e raportimit.

(a) ...

(g) Informacioni i mëposhtëm për segmentin (dhënia e informacionit shpjegues të segmentit është i nevojshëm në raportin financiar të ndërmjetëm të një njësie ekonomike vetëm nëse SNRF 8 *Segmentet e shfrytëzimit* kërkon që njësia ekonomike të japë informacion shpjegues për segmentin në pasqyrat e saj financiare vjetore):

(f) ...

(iv) një vlerë e aktiveve dhe pasiveve gjithsej për një segment të caktuar raportues, nëse shuma të tilla i jepen rregullisht shefit të marrjes së vendimeve në nivel operativ dhe nëse për të cilat ka pasur një ndryshim material nga shuma e paraqitur në pasqyrat e fundit financiare vjetore për këtë segment raportues.

(v) ...

(h) ...

## **Data e hyrjes në fuqi**

53 Cikli i përmirësimeve vjetore 2009-2011, i publikuar në maj 2012, ndryshoi paragrafin 16A. Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet* për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 e në vijim.

Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë ndryshim për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

**VENDIM**  
**Nr. 1, datë 10.1.2013**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI PROCEDURAT E EMËRIMIT TË ADMINISTRATORIT DHE KOMPETENCAT E TIJ”, NË ZBATIM TË NENIT 18, PIKA 4/C TË LIGJIT NR. 9072, DATË 22.5.2003 “PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 18 pika 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 13 të rregullores “Për procedurat e heqjes së një licence”, miratuar me vendimin nr. 68, datë 4.11.2005 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.1.2013, pasi shqyrtoi relacionin e grupit të punës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë personat e interesuar lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**  
**Nr. 3, datë 11.1.2013**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES DHE EMËRIMIT TË ADMINISTRATORIT, NË ZBATIM TË VENDIMIT TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 158, DATË 16 NËNTOR 2012 “PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCAVE PËR AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES DHE AKTIVITETIT TË FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICË”**

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 18 pika 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 13 të rregullores “Për procedurat e heqjes së një licence”, miratuar me vendimin nr. 68, datë 4.11.2005 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 158, datë 16 nëntor 2012 “Për fillimin e procedurave për heqjen e licencave shoqërisë “CEZ Shpërndarje”, për aktivitetin e shpërndarjes dhe të aktivitetit të furnizimit publik me pakicë”, nenit 4 të rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 10.1.2013, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.1.2013, pasi shqyrtoi relacionin e grupit të punës,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave të përzgjedhjes së administratorit potencial të shoqërisë “CEZ Shpërndarje”, emërimi i të cilit do të bëhet efektiv në rast të marrjes së vendimit përfundimtar për heqjen e licencës shoqërisë së interesuar, nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.



2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të përgatitë të gjitha procedurat në lidhje me zbatimin e këtij vendimi të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani

**VENDIM**  
**Nr. 4, datë 21.1.2013**

**PËR HEQJEN E LICENCAVE TË SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA PËR  
AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME  
VENDIMIN NR. 8, DATË 25.1.2008, TË NDRYSHUAR DHE PËR AKTIVITETIN E  
FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME  
VENDIMET E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 9, DATË 25.1.2008, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 18 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të Shqipërisë, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008; “Deklaratës rregullore”, miratuar me vendimin nr. 12, datë 3.3.2009, nenit 5, 6, 7 dhe 8 të rregullores “Për heqjen e licencave”, miratuar me vendimin nr. 68, datë 4.11.2005 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s; licencës “Për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 9, datë 25.1.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar; licencës për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 8, datë 25.1.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar; kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë dhe jofamiljarë, miratuar me vendimet nr. 108 dhe 109, datë 21.10.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s; kontratës së furnizimit me energji elektrike me KESH sh.a. dhe “CEZ Shpërndarje”, të miratuar me vendimin nr. 31, datë 31.3.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s; marrëveshjes së transmetimit mes OST sh.a. dhe “CEZ Shpërndarje” miratuar me vendimin nr. 3, datë 11.1.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.1.2013, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike për heqjen e licencës së shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes dhe të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike,

**VENDOSI:**

1. Heqje të licencës së aktivitetit të shpërndarjes së energjisë elektrike shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.

2. Heqje të licencës së aktivitetit të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.

3. Shoqëria “CEZ Shpërndarje” është përgjegjëse për kostot e shkaktuara ERE-s, Qeverisë Shqiptare dhe pjesëmarrësve të tregut, si rezultat i heqjes së licencave në përputhje me pikën 5.6 të licencës së shpërndarjes së energjisë elektrike dhe pikës 5.6 të licencës së furnizimit publik me pakicë.

4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë menjëherë Këshillin e Ministrave për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, që të veprojë për shpronësimin e aseteve të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.

5. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë menjëherë “CEZ Shpërndarje” për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani

**VENDIM**  
**Nr. 5, datë 21.1.2013**

**PËR VENDOSJEN E SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA NË ADMINISTRIM TË PÛRKOHSHËM DHE EMËRIMIN E ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA, NË ZBATIM TË VENDIMIT TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 4, DATË 21 JANAR 2013 “PËR HEQJEN E LICENCAVE PËR AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE AKTIVITETIT TË FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA”**

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 18 pika 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 13 të rregullores “Për procedurat e heqjes së një licence”, miratuar me vendimin nr. 68, datë 4.11.2005 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013 “Për heqjen e licencave të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 8, datë 25.1.2008, të ndryshuar, dhe për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimet e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 25.1.2008, të ndryshuar”, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 1, datë 10.1.2013 “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 4 të rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 10.1.2013, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.1.2013,

**VENDOSI:**

1. Vënien në administrim të përkohshëm të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., sipas nenit 18, pika 4 germa “ë” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

2. Gjatë periudhës së përkohshme të administrimit pezullohen të gjitha përgjegjësitë dhe kompetencat e organeve të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., si dhe të aksionarëve të saj në funksion të detyrimeve të licencës.

3. Të gjitha funksionet dhe kompetencat e administrimit të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., i kalojnë administratorit të emëruar nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.



4. Emërimi i z. Sahit Dollapi, si administrator i përkohshëm i shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., që të operojë dhe të mirëmbajë pajisjet, pasuritë dhe mjetet monetare, dhe llogaritë bankare të shoqërisë.

5. Administratori i emëruar sipas pikës 4 të këtij vendimi, në administrimin e përditshëm të shoqërisë, do të zbatojë rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe ka këto detyra të menjëhershme:

- Të marrë menjëherë në administrim shoqërinë “CEZ Shpërndarje” sh.a.;
- Të ndryshojë vulën e shoqërisë. Vula e re të reflektojë vënien nën administrim të shoqërisë;
- Në të gjithë korrespondencën e shoqërisë së vënë në administrim të përkohshëm, të reflektojë ndryshimet e ndodhura në statusin e shoqërisë;
- Të ndryshojë rregullin e hyrjes në ndërtesat dhe në mjediset ku ruhen pasuritë, dokumentacioni, informacioni, pajisjet, përdorimi i të cilave dëmton interesat pasurorë të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., duke zëvendësuar kodet dhe fjalëkalimet, dhe duke vendosur kufizime të rrethit të personave që kanë të drejtë të hyjnë në këto mjedise;
- Të ndryshojë ose të krijojë fjalëkalime të reja për hyrjet në rrjetin kompjuterik, duke lejuar hyrjen në të, vetëm të punonjësve të autorizuar të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.;
- Mund të ndryshojë kompetencat e personave, të cilët ushtrojnë veprimtari në emër dhe për llogari të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., duke autorizuar për ushtrimin e këtyre kompetencave punëmarrës të tjerë, dhe për këto ndryshime njofton palët e treta dhe rregullatorin;
- Të ndjekë menjëherë procedurat për ndalimin e pagesës së dividendëve, transferimit të kapitalit aksionar të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., si dhe pagesën e administratorëve të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., përveç shpërblimit për shërbimet që ata kanë bërë më parë.

6. Administratori i emëruar sipas pikës 4 të këtij vendimi, nuk mund të transferojë asnjë aset ose pasuri materiale të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., nëpërmjet shitjes, pengut, qirasë, shkëmbimit apo formave të tjera.

7. Statusi i shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., sipas këtij vendimi dhe administratori i emëruar sipas pikës 4 të këtij vendimi, bëhen publike nëpërmjet depozimit të këtij vendimi në QKR.

8. Depozitimi dhe publikimi i këtij vendimi në të dhënat e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. me numër NIPT: K72410014H, do të realizohet sipas autorizimit bashkëlidhur këtij vendimi.

9. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë menjëherë administratorin e emëruar sipas pikës 4 të këtij vendimi dhe shoqërinë “CEZ Shpërndarje” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Hyri në shtyp më 28.1.2013  
Doli nga shtypi më 29.1.2013

|  |                  |
|--|------------------|
|  | Formati: 61x86/8 |
|--|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 38 lekë